



## PËRMBLEDHJE E METODOLOGJISË

# ANALIZA GJINORE MBI EKONOMINË JOFORMALE NË KOSOVË

## PARATHËNIE

Siç ka observuar Qeveria e Kosovës, ekonomia jo-formale vazhdon të ndikojë negativisht në të hyrat e buxhetit të Kosovës, konkurrencën e padrejtë dhe punësimin e padeklaruar<sup>1</sup>. Edhe pse disa politika synojnë të adresojnë jo-formalitetin<sup>2</sup>, asnjëra nga to nuk është e bazuar aq sa duhet në analiza gjinore. Ndërkaq, Qeveria e Kosovës është zotuar se do të aplikojë Vlerësime të Ndikimit Gjinor të cilat do të informojnë ligjet, politikat dhe programimet<sup>3</sup>. Edhe Bashkimi Evropian (BE) është zotuar se do ta mbështesë zhvillimin e analizave gjinore në sektorë specifik për të informuar programimet e veta në [Planin e tretë të Veprimit Gjinor të BE-së](#)<sup>4</sup>. Në të vërtetë, Kosovës i mungojnë të dhëna të sakta për dallimet gjinore mbi përfshirjen në ekonominë jo-formale dhe shfrytëzimin e kohës. Analiza gjinore është thelbësore për informimin e ligjeve, politikave dhe programeve të qeverisë që të adresojnë problemet e ekonomisë jo-formale dhe të nxisin rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse duke siguruar një qasje që nuk shkakton dëme. Konkretisht, ky hulumtim synon të informojë strategjitë e qeverisë për të adresuar ekonominë jo-formale dhe strategjitë e tjera të zhvillimit ekonomik, duke synuar në veçanti përmbytjen e kriterëve për anëtarësim në BE dhe zbutjen e efekteve të pandemisë COVID-19.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është pjesë e një Koalicioni Rajonal për Barazi Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE (EQUAPRO), i bashkëfinancuar nga BE-ja dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida). Aksioni, i implementuar nga ky koalicion, përfshin bashkëpunimin me BE-në dhe palët e interesuara të qeverisë për të kryer analiza gjinore në sektorët ku nuk ka analiza të mjaftueshme, drejt zbatimit të Planit III të Veprimit Gjinor (GAP III) dhe informimit të programeve të mbështetura nga BE-ja. Konsultimet me palët e interesuara të BE-së dhe qeverisë kanë vë në pah se ekonomia joformale është një fushë ku analiza gjinore nevojitet urgjentisht, veçanërisht për të informuar reformat e vazhdueshme ligjore dhe të politikave. Prandaj, në frymën e zotimeve të GAP III për koordinim, BE-ja, Sida dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) kanë rënë dakord të grumbullojnë burimet për të mbështetur “Analizën Gjinore mbi Ekonominë Joformale në Kosovë” shumë të nevojshme. BE-ja dhe Sida janë duke financuar hulumtimin në përgjithësi, duke përfshirë anketimin në familjet urbane, ndërsa FAO është duke financuar anketën në familjet rurale si pjesë e mbështetjes së saj më të gjerë për RrGK-së për një “Vlerësim të veçantë mbi bujqësinë digjitale, gjininë dhe të rinjtë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike”. Pyetjet e bëra në lidhje me ekonominë informale në familjet urbane dhe ato rurale do të shtrohen në të njëjtën mënyrë, duke përdorur të njëjtën metodologji, duke mundësuar krahasueshmëri. Qëllimi i përgjithshëm i të dyja analizave gjinore është të mbështesë Qeverinë e Kosovës, FAO-n dhe BE-në duke ofruar

<sup>1</sup> Zyra e Kryeministrit, [Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016 -2021](#), 2016, f. 27.

<sup>2</sup> Ministria e Financave, [Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale. Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023](#), 2019; Zyra e Kryeministrit: Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Programi për Statistikat Zyrtare \(2018 – 2022\)](#), 2017; Qeveria e Kosovës, [Programi i Reformës Ekonomike 2020-2022](#), 2020.

<sup>3</sup> Zyra e Kryeministrit, [Strategjia dhe Plani I Veprimit per Rregullimin më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021](#).

<sup>4</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, [Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit, Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës \(2019-2021\) Vlerësimi i Komisionit](#), 2019.

analiza të nevojshme gjinore që mund të informojnë ligjet, politikat dhe programet drejt adresimit të ekonomisë jo-formale dhe mbështetjes së gjithëpërfshirjes ekonomike, veçanërisht në zonat rurale.

## METODOLOGJIA

Në këtë hulumtim, "ekonomia jo-formale", e njohur edhe si "ekonomia gri" ose "ekonomia në hije", i referohet të gjitha aktiviteteve ekonomike të kryera nga punëtorët që janë të pambuluara ose të mbuluara në mënyrë të pamjaftueshme nga marrëveshjet formale. Organizata Ndërkombëtare e Punës e përkufizon sektorin jo-formal si një sektor në të cilin marrëdhëniet e punës bazohen kryesisht në punësim të rastësishëm, sipas lidhjeve familjare apo marrëdhënieve personale dhe shoqërore në vend të marrëveshjeve kontraktuale me garanci formale. Kjo përfshin punët si në sektorin formal ashtu edhe në atë jo-formal, në ndërmarrje dhe në ekonomi familjare.

## Pyetjet hulumtuese

Pyetja e përgjithshme hulumtuese është: Si ndryshon përfshirja e grave dhe burrave të ndryshëm në ekonominë jo-formale? Nënpyetjet kryesore përfshijnë:

- Deri në çfarë mase korniza ligjore dhe politike adreson ekonominë jo-formale duke përfshirë qasjen transformuese gjinore dhe si mund të përmirësohet kjo?
- Cilat janë perceptimet e ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me ekonominë informale?
- Si e përdorin gratë dhe burrat e ndryshëm kohën e tyre të punës së paguar dhe papaguar, si dhe të aktiviteteve sociale, personale, dhe qytetare në ekonominë familjare rurale dhe urbane?
- Si ka ndikuar COVID-19 aktivitetet e prodhimit dhe gjenerimit të të ardhurave në nivelin e ekonomive familjare, veçanërisht lidhur me ekonominë joformale?
- Cilat mund të jenë strategjitë për adresimin e ekonomisë jo-formale duke përdorur qasjen transformuese gjinore?

## Metodat e Kërkimit dhe Burimet e të Dhënave

Hulumtimi do të përdorë metoda të përziera të cilat kontribuojnë në vlefshmërinë e gjetjeve përmes trekëndëzimit të studiuesve dhe gjetjeve që dalin nga përdorimi i metodave dhe burimeve të ndryshme të të dhënave. Metodatat do të përfshijnë:

- Shqyrtim i literaturës ekzistuese, të dhënave dhe statistikave institucionale.
- Fokus grupe të realizuara me gra dhe burra të ndryshëm në rajone të ndryshme gjeografike.
- Një anketë përfaqësuese me ekonominë familjare në mbarë Kosovën duke përdorur kampionimin e rastësishëm me shumë faza me 1,603 ekonomi familjare në mbarë Kosovën, duke përfshirë gra dhe burra të të gjitha etnive nga 38 komunat e Kosovës. Sondazhi do të përdorë pyetjet e Eurostat dhe Institutit Evropian për Barazi Gjinore që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e kohës dhe punës, punësimin, shëndetin dhe sigurinë në punë, duke mundësuar kështu krahasime me vendet e tjera.
- Intervistat e thelluara me gra dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë intervistat e informantëve kyç; zyrtarë përkatës të nivelit lokal dhe kombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë të njohur.

Anketa do të kryhet në mars 2022, me analizën gjinore për bujqësinë e përfunduar në qershor dhe analizën gjinore për ekonominë jo-formale të përfunduar në vjeshtën e 2022.

## KONTAKTI

Për informacione të mëtejshme rreth këtyre analizave gjinore ose metodologjive të plota, ju lusim të kontaktoni Nicole Farnsworth, Drejtoreshë e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimeve në RrGK: [nicole@womensnetwork.org](mailto:nicole@womensnetwork.org)